



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RAPORTI VJETOR 2025

Oda e Mjekëve të Kosovës



Janar 2026, Prishtinë

Përmbajtja:

RAPORTI VJETOR 2025.....	1
1. Infrastruktura juridike	3
2. Këshilli Drejtues.....	3
3. Këshilli Mbikëqyrës	3
4. Anëtarësimi	3
5. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	5
6. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	7
7. Licencimet.....	7
10. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	8
11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së.....	8
12. Raporti financiar.....	9
12.1 Raporti financiar deri me 31 dhjetor 2025	9
12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	9
12.3 Prokurimi.....	11
13. Aktivitete të tjera	12
13.1 Simpoziumi i III i Kardiologjisë - “Updates in Interventional Cardiology” ..	12
13.2 Kongresi i VII i Mjekësisë - Emergjenca, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni në Kriza Mjekësore	13
13.3 Fuqizimi Institucional përmes Partneriteteve Strategjike Financiare në Shërbim të Anëtarëve të Odës së Mjekëve të Kosovës.....	13
13.4 Botimi i “Revista Mjeku”.....	14
13.5 Marrëdhëniet ndërkombëtare	14
13.6 Bashkëpunimi profesional.....	15
14. Plani i veprimit për 2026	16

1. Infrastruktura juridike

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2025 ka mbajtur një mbledhje të rregullt. Mbledhja e datës 20 shkurt, ku u shqyrtuan dhe aprovuan:

- Raporti i punës së OMK-së për vitin 2024;
- Projekt buxheti i OMK-së për vitin 2025
- Plotësim/Ndryshimi i Rregullorës për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim

Gjithashtu në këtë mbledhje është bërë dhe betimi i dy anëtarëve të rinj të Kuvendit nga dy njësi zgjedhore ku janë zëvendësuar përfaqësuesit nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit dhe nga Klinika e Anestezionit

2. Këshilli Drejtues


Gjatë vitit 2025, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 12 takime, ku janë pranuar 69 lëndë, nga të cilat janë marr 64 vendime sipas kërkesave/ankesave të pranuar.

3. Këshilli Mbikëqyrës


Gjatë vitit 2025, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur 17 takime, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues dhe të organeve të tjera të OMK-së, ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

4. Anëtarësimi

Gjatë vitit 2025 janë anëtarësuar 311 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve të odës ka arritur në 5619 mjekë, nga të cilit 3774 mjekë janë të punësuar në sektorin publik, 420 mjekë në sektorin privat, 786 mjekë pensionist dhe 639 mjekë të papunë.



Grafikoni 1. Anëtarësimet deri me 31 dhjetor 2025



Grafikoni 2. Anëtarët e odës paraqitur sipas moshës

Bazuar në tabelën më lartë shihet se mosha mesatare e mjekëve anëtarë është 47 vjeç, anëtari më i ri është 24 vjeç, kurse anëtari më i vjetër është 89 vjeç.

5. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të Odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2025	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2025	Sanksionet e shqiptuara për vitin 2025	Sanksionet e ekzekutuara për vitin 2025	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	65	82	N/A	N/A	121
Këshilli Etik	71	71*	Rekomandime kolegjinale 22 Qortime publike 6 Gjobë 3	Rekomandim e kolegjinale 14	97
Gjyqi i Nderit	9	10	///	///	1
Certifikatat e të kaluarës etike	943**	///	///	///	///

* Në Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2025 janë të përfshira edhe vendimet e nxjerra për lëndët e bartura nga viti 2024.


Këshilli Etik në shqyrtim të drejtpërdrejtë, ka mbajtur nëntë seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilat është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë).

** Gjatë vitit 2025, janë lëshuar 943 certifikata për të kaluarën etike, ku 848 certifikata janë lëshuar për mjekët që kanë marr certifikata për shtesa mbi pagë në sektorin publik Rregullorja nr. 02/2023, dhe mjekët që kanë marr certifikata edhe viteve të kaluara. Ndërsa, 95 certifikata janë lëshuar për mjekët për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Prej tyre 91 certifikata janë lëshuar për Doktorë të Mjekësisë, 4 certifikata për specialistë.

CERTIFIKATA TË LËSHUARA PËR TË KALUARËN ETIKE



Grafikoni 3. Certifikata për të kaluarën etike deri me 31 dhjetor 2025




Grafikoni 4. Data e diplomimit të mjekëve që kanë marrë certifikatë për të kaluarën etike.

Gjatë vitit 2025 nga numri total i mjekëve që kanë kërkuar certifikata për të kaluarën etike, janë 95 mjekë, 76.84% e të cilëve që kanë diplomuar në katër vitet e fundit.


6. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë vitit 2025, ka akredituar 167 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 10 shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, 2 nga kërkesat janë refuzuar për përkrahje financiare ndërsa 8 prej tyre janë aprovuar dhe 1 është anuluar.



7. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë vitit 2025, ka organizuar 2 provime të rilicencimit dhe gjithashtu ka lëshuar 998 licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky komision i ka lëshuar gjithsej 12022 licenca.

10. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Gjatë vitit 2025, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka zhvilluar 12 takime, në të cilat janë shqyrtuar gjithsej 134 kërkesa. Nga këto:

Janë miratuar 116 vendime, prej të cilave:

- 86 vendime për leje-hulumtime
- 30 vendime për raport përmbyllës

Janë refuzuar 6 kërkesa, konkretisht:

- 4 kërkesa për pajisje me akt për leje-hulumtim
- 2 raporte përmbyllëse

12 lëndë janë bartur për shqyrtim në periudhën vijuese të vitit 2026.

11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së

Gjatë vitit 2025, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 17 kërkesa për përkrahje financiare dhe 8 kërkesa për shpenzime të varrimit. Komisioni ka nxjerrë 17 vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara për përkrahje financiare dhe 7 vendime për shpenzime të varrimit, 1 vendim për refuzim të kërkesës.

12. Raporti financiar

12.1 Raporti financiar deri me 31 dhjetor 2025

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 31 DHJETOR 2025					
Gjendja në bankë me 31.12.2024					€ 843,465
1.0 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4	TOTAL
1.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.1.1 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 342,715	€ 154,314	€ 3,000	€ 3,320	€ 503,349
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 1,800	€ 3,100	€ 26,440	€ 600	€ 31,940
1.2 Licencimi	€ 13,647	€ 12,490	€ 10,625	€ 12,190	€ 48,952
1.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,714	€ 13,220	€ 27,248	€ 30,819	€ 83,001
Të hyrat për periudhën 01.01.2025-31.12.2025					€ 667,242
TOTAL TË HYRAT					€ 1,510,707
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 84,791	€ 74,775	€ 74,853	€ 79,468	€ 313,887
2.2 Material shpenzues	€ 518	€ 860	€ 639	€ 538	€ 2,554
2.3 Reprerentacioni	€ 846	€ 756	€ 778	€ 705	€ 3,085
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 52,796	€ 8,480	€ 37,453	€ 39,146	€ 137,875
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 7,347	€ 9,925	€ 5,591	€ 13,645	€ 36,508
2.6 Shpenzimet e asetëve		€ 834	€ 2,940	€ 695	€ 4,469
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,450	€ 5,150	€ 25,400	€ 6,505	€ 45,505
Shpenzimet për periudhën 01.01.2025-31.12.2025					€ 543,884
Gjendja në bankë me 31.12.2025					€ 966,823

1.3 *Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, regjistrim në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, reregjistrim në regjistrin e OMK-së, faksimili, faksimili i dytë, certifikata për të kaluarën etike profesionale, taksa për paraqitjen e provimit, kongreset, simpoziumet, seminarët, lejimi për hulumtime për persona juridik, të ardhurat nga interesi i -PCB-së, të hyrat nga të ardhurat e tjera.

2.5*Faksimili, shpenzimet për botimin e revistës, organizimi i mbledhjeve të kuvendit, shpenzimet e ID kartelave të Odës, shpenzime të përkthimeve/lektorimit, meditje për udhëtime zyrtare, trajnime për stafin, mirëmbajtja e softuerit për financa, shpenzimet e tel., shpenzimet e int., shpenzimet e postës, pajisje të IT-së, shpenzimet bankare, shpenzimet e pastrimit, shpenzimet e transportit, shpenzimet e tjera operative.

12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës, gjatë vitit 2025 ka ndarë përkrahje financiare në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në vlerë totale prej 137,874.74€. Më poshtë janë pasqyruar procedurat lidhur me shpërndarjen e këtyre përkrahjeve:

Bazuar në konkursin publik të shpallur me datë 15 mars 2025 për përkrahjen financiare të aktiviteteve të veçanta të EVP-së, OMK ka akorduar përkrahje financiare për:

- Asociacionin e Psikiatërve të Kosovës, "Programi Vjetor i EVM-së për profesionistët e shëndetit mendor", në vlerë 2,550.00€;
- Kosovo Resuscitation Society, "Kursi i Reanimimit Kardiopulmular Bazik", në vlerë 10,890.00€;
- Shoqatën e Nefrologëve të Kosovës, "Kongresi Vjetor i Nefrologjisë ISN CME Onkonenefrologjia", në vlerë 10,890.00€;
- Kosova Organization of Medical Student " Shkolla verore per doktorët e rinje 2", në vlerë 7,095.65€;
- Shoqatën e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë - PRAK, "Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve në institucionet shëndetësore", në vlerë 6,496.34€;
- Shoqatën e Kirurgëve Pediatrik të Kosovës, "Kursi ATLS- Advanced Trauma Life Support", në vlerë 7,500.00€;
- Aksioni për Nena dhe Femijë, "Dhuna në baza gjinore", në vlerë 4,430.89€

Kongresi i VII i Odës së Mjekëve të Kosovës, organizuar me datë 21-23 nëntor 2025.

- Kongresi i VII, "Emergjenca, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni në Kriza Mjekësore: Sfidat e së Ardhmes", në vlerë prej 41,419.01€;
- Trajnimi për Diagnostikimin e Ultratingullit Osteomuskular, në vlerë 2,999.00€ i dedikuar specialistëve të Mjekësisë së Sportit të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive në Prishtinë.
- Trajnimi për Diagnostikimin e Ultratingullit Osteomuskular në vlerë 1,800.00€ dedikuar për QKMF Gjilan, QKMF Drenas dhe QKMF Obiliq,

Me datë 17 mars 2025, është bërë shpallja publike për **Përkrahjen financiare të punimeve shkencore** më të mira të vitit 2024. Përfitues të mjeteve ishin 5 persona.

- Pesë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2024, në vlerë prej 5,000.00€.
- Me qëllim të përkrahjes së zgjerimit dhe avancimit të edukimit të vazhdueshëm profesional, Oda e Mjekëve të Kosovës ka mbështetur financiarisht 9 mjekë specialistë

në realizimin e profilizimeve të tyre të veçanta profesionale, në vlerë prej 34,807.85€ duke u mundësuar ndjekjen e trajnimeve një mujore në fushat përkatëse.

Nga Klinika e Pediatriisë dhe Institutet Paraklinike, 9 mjekë specialistë kanë përfituar në profile të ndryshme, përfshirë Gjenetikën Klinike, Neurologjinë/Endokrinologjinë Pediatrike, Gastrohepatologjinë, Pediatrinë e Përgjithshme si dhe Nefropatologjinë/Uropatologjinë.

Gjithashtu përmes marrëveshjes ndërinstytucionale për delegim të fondeve dhe implementim mes OMK dhe projektit Luxembourg Development KSV/017 212749, është përkrahur trajnimi për Radiologji intervente endovaskulare cerebrale në Turqi në vlerë 2,000.00€

12.3 Prokurimi

Gjatë periudhës raportuese, OMK-ja ka zhvilluar procedura të prokurimit të ndara sipas vlerës së tyre, përkatësisht procedura me vlera të vogla dhe procedura me vlera të mëdha. Datat e paraqitura më poshtë i referohen datave të njoftimit për dhënie të kontratës.

Procedura të prokurimit me vlera të vogla

Në kuadër të procedurave me vlera të vogla janë realizuar këto aktivitete:

- Procedura e prokurimit për furnizim me pajisje të teknologjise informative – Vlera 2,940.00€
- Procedura e prokurimit për shërbime të Avokatise, përfaqesim dhe keshillim ligjor – Vlera 2,999.00€
- Thirrje për Shprehje të Interesit – Trajner për mbajtjen e kursit për Ultrazërin Diagnostik të Sistemit Osteomuskular - Vlera 2,999.00 €
- Procedura e prokurimit për ndërtimin e stendave për Kongresin dhe Panairin e VII-të Mjekësor-Vlera 2,999.00 €
- Procedura e prokurimit për shërbime të transportit rrugor Taxi për OMK-në - Vlera 2,700.00 €

Procedura të prokurimit me vlera të mëdha

Në kuadër të procedurave me vlera të mëdha janë realizuar këto aktivitete:

- Procedura e prokurimit për transport ajror për OMK-në – Vlera 28,560.00

- Procedura e prokurimit per transport per Furnizim me Faksimil per OMK-ne, - Vlera 16,800€
- Procedura e prokurimit per transport për furnizim me material shpenzues për zyrat e OMK-së - Vlera 18,000.00 €
- Procedura e prokurimit per transport për Auditim FunkSIONAL dhe Financiar të OMK-së – Vlera 4,380.00 €

Të gjitha procedurat e lartcekura janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa kontratat janë lidhur brenda afateve të parapara.

13. Aktivitete të tjera

13.1 Simpoziumi i III i Kardiologjisë - “Updates in Interventional Cardiology”

Oda e Mjekëve të Kosovës së bashku me projektin e qeverisë së Luxemburgut KSV/017 dhe në bashkëpunim me National Institute Surgery Cardiac and De Cardiologie Interventionnelle (INCCI) me datë 22 nëntor 2025, organizuan simpoziumin e III me pjesëmarrje ndërkombëtare nga lëmia e kardiologjisë me temë “Updates in Interventional Cardiology”.

Disa nga temat që u trajtuan në këtë simpozium janë:

- Sindroma akute koronare në Kosovë gjatë 25 viteve të fundit
- On the quest for a National cardiac Center in Kosovo insides from INCCI in Luxembourg over the last 30 years
- Përvoja e Shqipërisë në luftën kundër sëmundjeve kardiovaskulare
- Biomarkues e rinj në No-Reflow Fenomen, etj.

Ky simpozium u organizua me qëllim të ngritjeve të kapaciteteve profesionale dhe kishte për target gurrp Kardiologët, Kardiokirurgët si dhe specialist të Mjekësisë Interne

13.2 Kongresi i VII i Mjekësisë - Emergjencia, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni në Kriza Mjekësore

Kongresi i VII-të i Odës punimet i mbajti me datë 21-23 nëntor 2025, ndërsa hapjen solemne e mbajti me datë 20 nëntor. Në këtë ceremoni u shpërndanë mirënjohje anëtarëve të OMK-së të cilët gjatë këtij viti u pensionuan dhe dekorata post mortum për familjarët e mjekëve të cilët kanë vdekur gjatë vitit 2025.

Me 21 dhe 23 tetor në Kongresin e VII-të të Mjekësisë me temën “Emergjencia, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni në Kriza Mjekësore” ligjëruan gjithsej 50 ligjërues ku 44 prej tyre ishin ligjërues të huaj ndërsa pjesa tjetër ishin vendor. Në Kongres gjithashtu janë regjistruar 2000 mjekë anëtarë të Odës. Gjatë dy ditëve të punimeve të Kongresit ligjërimi është bërë në 3 salla njëkohësisht. Po ashtu panairi i Kongresit u mbajt njëkohësisht në njerën prej sallave ku mbaheshin punimet e Kongresit.

13.3 Fuqizimi Institucional përmes Partneriteteve Strategjike Financiare në Shërbim të Anëtarëve të Odës së Mjekëve të Kosovës

Oda e Mjekëve të Kosovës ka shënuar zhvillime të rëndësishme në drejtim të fuqizimit institucional dhe përmirësimit të shërbimeve për anëtarët e saj, përmes thellimit të bashkëpunimeve strategjike me partnerë financiarë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me ProCredit Bank, marrëveshje e cila synon përmirësimin e pozitës financiare të mjekëve dhe lehtësimin e qasjes së tyre në produkte dhe shërbime bankare me kushte të favorshme dhe ekskluzive. Ky partneritet përfaqëson një hap strategjik në mbështetje të profesionistëve shëndetësorë, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të mira për stabilitet financiar, zhvillim profesional dhe mirëqenie afatgjatë për mjekët.

Po ashtu, gjatë këtij tremujori është formalizuar edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Vllësa Pagesa, e cila mundëson që anëtarët e Odës të realizojnë pagesat e faturave të pranuar nga Oda në të gjitha degët e kësaj kompanie të specializuar për shërbime financiare. Ky bashkëpunim synon rritjen e efikasitetit administrativ dhe lehtësimin e proceseve të pagesave për anëtarësinë, duke ofruar qasje më të shpejtë dhe më praktike në shërbimet përkatëse.

13.4 Botimi i “Revista Mjeku”

Oda e Mjekëve të Kosovës botoi për herë të parë “Revista Mjeku” me datë 30 mars 2021, me qëllim të informimit të publikut dhe mjekëve rreth aktualitetit në fushën e shëndetësisë, informimit të publikut rreth ofrimit të shërbimeve shëndetësore, si dhe ofrimit të reklamimit të produkteve të ndryshme mjekësore.

Revista “Mjeku” u botua 4 herë gjatë vitit 2025 dhe trajtoi temat: Fiziatra, fizioterapia dhe mjekësia sportive, 100 vjet për shëndet, obezitetit dhe kequshqyerja, emergjencat dhe urgjencat si dhe tema të lira rreth shëndetësisë.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

13.5 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare Oda e Mjekëve të Kosovës ka marrë pjesë në këto takime:

- **Asamblenë e 128-të e Asociacionit Mjekësor të Gjermanisë** - ku pikat kryesore të diskutimit në këtë asamble ishin: Kujdesi shëndetësor i së ardhmes - më shumë koordinim i kujdesit dhe orientim më i mirë për pacientët, mungesa e punëtorëve shëndetësor të kualifikuar dhe reforma strukturore spitalore, Akti për Forcimin e Kujdesit Shëndetësor.
- **Komitetin e Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME)** - takimet e mbajtura në muajin mars në Lubjanë dhe në muajin nëntor në Amsterdam. Tema diskutimi gjatë mbledhjes ishin: Parimet, pacientët dhe etika, shëndetësia digjitale, praktika profesionale dhe sistemet shëndetësore, shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve.

Këto takime kanë qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave mjekësore evropiane dhe shkëmbimin e përvojave për të ndihmuar në zhvillimin dhe avancimin e politikave shëndetësore.

13.6 Bashkëpunimi profesional

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2025	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për vitin 2025	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për vitin 2025	Lëndët e bartura nga periodhat paraprahe
Kryetari i Odës	13	7	0	0	0

Në këtë periudhë kohore gjashtë lëndët e pranuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë, OMK ka kthyer prapa lëndët me arsyetimin se nuk është duke u ekzekutuar asnjë pagesë për ekspertët e caktuar nga Oda e Mjekëve, ndërsa është kërkuar nga Komisioni për Çështje Etike, Prokurori dhe zv.Prokurori i OMK-së, për caktim të ekspertëve.

14. Plani i veprimit për 2026

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH- të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuara deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejen për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës, është bërë plani detal i objektit nga arkitektët dhe gjithahtu OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development kanë përfunduar procedurat e prokurimit për fillimin e punimeve dhe është përzgjedhur operatori ekonomik për zhvillimin e punimeve të objektit. Hapi i ardhshëm i projektit është fillimi i punimeve për ndërtim.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revista Mjeku”.
- Fillimi i botimit të numrit shkencor të “Revista Mjeku”.
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e IV të OMK-së.
- Lansimi i modulit për EVP dhe regjistrimi i të gjitha shoqatave në platformën digjitale
- Ndërlidhja e platformës digjitale me e-kosovën